



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

URDHËR EKZEKUTIMI

Bazuar në ligjin 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” në konfirmimin e Prefektit të Qarkut Berat.

Nr. 3111 Prot, Datë 31/03/2020 për marrjen në dorëzim të aktit :

URDHËROJ

- Të zbatohet vendimi Nr. 20 Datë 31/03/2020 i Këshillit të Bashkisë.
- Përplioni dhe listën e institucioneve ,ndërmarrjeve,zyrave që do t'u adresohet vendimi.
- Ngarkohet** : Drejtoria e Shërbimit Social , Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.
- Respektimi afatet kohore dhe ligjore

KRYETARI I BASHKISË

ERVIN DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

V E N D I M

NR 20 Datë 31/ 03/ 2020

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË MBROJTJES CIVILE TË BASHKISË, PËR TË
MBËSHETTUR SHTRËSAT NË NEVOJË NË KUSHTET E EPIDEMISË SË
SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 8, të gërmës “b”, pika 1.1 të nenit 9, pikës 1 të nenit 24, 40, 54, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, VKM nr.236, datë 19.03.2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” dhe VKB nr.66, datë 26.12.2019, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1. Miratimin e shumës prej 6.500.000 (gjashtëmilion e pesëqindmijë) lekë për të ndihmuar 1200 familje në nevojë, ku përfshihen shtresat në nevojë sipas përcaktimit në VKM nr.236, datë 19.03.2020, si edhe familjet në varfëri ekstreme të evidentuara nga shtabet koordinuese në terren të drejtuara nga Administratorët, me produkte ushqimore dhe joushqimore, minimal, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

ERVIN CECA



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Bora Agalliu

Vendimi u miratua me 28

 vota kundër

 vota abstenim